

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES



14-20 KORRIK JAVA E MBROJTJES



JM

SHKODËR, QENDËR EMERGJENCASH NË ISH-REPARTIN USHTARAK

Ish-reparti i ndërlidhjes në **Bushat** do të kthehet në **Qendër Rajonale të Emergjencave Civile**. Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, i shoqëruar nga drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, **Haki Çako**, dhe **përfaqësues** të pushtetit vendor, vizitoi bazën ku do të ndërtohet kjo qendër.





VIZITA E KOMANDANTIT TË NATO-S NË SHQIPËRI

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, priti Admiralin **Pierre Vandier**, komandantin e Komandës Supreme të NATO-s për Transformimin, në **vizitën** e tij të parë në Shqipëri. Theksi i diskutimit ishin sfidat e sigurisë aktuale, bashkëpunimi me aleatët, **modernizimi** i Forcave të Armatosura dhe forcimi i kapaciteteve mbrojtëse përmes **investimeve** në industri dhe inovacion.

★★★★★

mod.gov.al

JM



FA TË ANGAZHUARA NË SHUARJEN E ZJARREVE

Forcat e Armatosura po **angazhohen** në të gjithë territorin e vendit nga toka dhe ajri për shuarjen e **zjarreve**.


Në **bashkëpunim** me zjarrfikësit dhe strukturat vendore të emergjencave civile, efektivet kanë punuar për **izolimin** dhe shuarjen e disa **vatrave** të rrezikshme gjatë shtatë ditëve të fundit.



MINISTRI VENUGU NË BAZËN AJRORE TË FARKËS

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, zhvilloi një takim me efektivët e **Forcës Ajrore** në Bazën Ajrore të Farkës, ku shprehu mirënjohjen për punën dhe përkushtimin e tyre të përditshëm. Ai **vlerësoi** guximin dhe **profesionalizmin** që tregojnë në çdo mision, shpeshherë në kushte të vështira, duke qenë **gjithmonë** në **shërbim** të qytetarëve dhe mbrojtjes së atdheut.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES


EFEKTIVËT E XHENIOS PËRMIRËSOJNË AKSIN SHËNGJERGJ-KROI I KUQ

Efektivët e batalioni të Xhenios kanë ndërhyrë për përmirësimin e kalueshmërisë në një segment rrugor prej 4 kilometrash në aksin Shëngjergj-Kroi i Kuq. Ky segment ka rëndësi të veçantë strategjike, pasi mundëson lëvizjen e sigurt të Forcave të Armatosura drejt poligonit të Bizës, si dhe ndihmon banorët e zonës për akses në kullotat verore.

JM

★★★★★

mod.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI VENUGU NDERON DËSHMORIN ARBEN ANAMALI

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në ceremoninë përkujtimore në Shkodër në nder të Arben Anamalit, i shpallur “Dëshmor i Atdheut” për aktin e tij heroik në shërbim të jetës së tjetrit. Në prani të autoriteteve vendore, përfaqësuesve të institucioneve dhe familjarëve, ministri nderoi kujtimin e Anamalit si një shembull të rrallë guximi, përkushtimi dhe humanizmi.

★★★★★

mod.gov.al


JM

PASTRIMI I THETHIT NGA FORCAT E XHENIOS

Forcat e Batalionit të Xhenios të Forcave të Armatosura janë angazhuar në operacionin e pastrimit të mbetjeve inerte në zonën e Thethit, në mbështetje të ekzekutimit të vendimeve ligjore për prishjen e ndërtimeve pa leje në territorin e mbrojtur.

JM





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



MINISTRI I MBROJTJES TAKIM ME DY DEPUTETË GJERMANË

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, priti në një takim **Tilman Kuban**, anëtar i **Bundestagut** gjerman dhe zëdhënës për Çështjet Evropiane i grupit parlamentar **CDU/CSU**, si dhe **David Preisendanz**, **deputet** dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet e Bashkimit Evropian. Në takim u **diskutuan** sfidat e sigurisë në rajon, rëndësia e **bashkëpunimit** ndërinstitutional, thellimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, si dhe **mbështetja** për **integrimin** e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

★★★★★